



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.953/22

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “L...” Sh.p.k me seli në Ferizaj, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.175/20 të datës 18.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.12.2022, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.175/20 të datës 18.06.2021, vërtetohet.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.175/20 të datës 18.06.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “L...” Sh.p.k me seli në Ferizaj, është anuluar aktvendimi nr.06.2/11-2016 i datës 13.12.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “L...”Sh.p.k me seli në Prishtinë, t’ia kthej detyrimet e paguara më tepër

në emër të taksave doganore importuese në vlerë prej 1,060.31€ (njëmijë e gjashtëdhjetë euro, e tridhjetë e një cent), të cilat detyrime janë paguar sipas Deklaratës Unike Doganore R-33610/06.12.2016 të ZBD Prizren. Shpenzimet e procedural bien në barrë të secilës palë ndërgjyqëse.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet në tërsi si e bazuar ankesa e të paditurës – Dogana e Kosovës, Prishtet aktgjykimi A.nr.175/20 i datës 18.06.2021 si të pa bazuar në ligj, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar me ligj duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 81.G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar me nr.06.2/11-2016 i datës 13.12.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë “K.P.T...”-Ferizaj, për rishqyrtimin e aktvendimit numër R-33610/06.12.2016 të lëshuar nga ZBD Prizren si të bazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit NTP “L...”Sh.a me seli në Ferizaj, t’ia kthej mjetet e paguara në emër të taksave doganore në vlerë prej 1,060.31€, të caktuara me aktvendimin e ZBD Prizren nr.06.2/11-2016 i

datës 13.12.2019. Me arsyetim se e paditura nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë të dokumentacionit përcjellës të mallit, ngase e paditura ka shmangur në tërësi vretjet dhe rekomandimet e gjykatës të dhënë në aktgjykimin A.nr.679/17 dt.14.10.2019, për mos anashkalimin e metodave të vlerësimit pa u vërtetuar gjendja faktike e dokumentacionit të mallit lëndor se është paguar vlera e transaksionit sipas faturës së mallit , konform nenit 33 të kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Ndër të tjera ka theksuar se paditësi ka dëshmuar faturën dhe pro-faturën përcjellëse të mallit nr.011/2016 urdhërpagesa ndërkombëtare datës 21.11.2016 dhe 29.09.2016 .... Bankë, dt.23.12.2016 .... të cilat pagesa janë bërë pikërisht për numrin e faturës përcjellëse të mallit lëndor, me të cilën është deklaruar dhe zhdoganuar malli lëndor, të cilat dokumentacione janë në tërësi të harmonizuar në kuptim të vlerës së mallit në përputhje me dispozitat 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, kështu gjykata e shkallës së parë ka vlersuar se malli lëndor duhet të vlerësohet sipas nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 respektivisht sipas vlerës së transaksionit që paraqet çmimin e vërtet të paguar për mallrat e shitura eksport në Kosovë. Krejt në fund ka theksuar se e paditura nuk ka bërë një vlerësim të drejtë me rastin e përcaktimit të vlerës së mallit doganor dhe nuk ka nxjerr një konkluzion të drejtë në aspektin e gjendjës faktike lidhur me dokumentacionin e mallit të paraqitur me DUD-in R-33610/06.12.2016 të ZBD Prizren, për arsye se e paditura nuk shqyrton fare dokumentacionin e mallit lëndor për të vërtetuar vlerën e transaksionit, duke iu shmangur në tërësi vlerësimit të faturës, pagesave bankare. Andaj vlerësimi i till i dokumentacionit të mallit nga e paditura me aplikimin e metodës së 6 të vlerësimit neni 35 i Kodit të doganës dhe të Akcizave është e pakuptueshme dhe në kundërshtimi me dispozitat ligjore nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera

të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron me që gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe KDAK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjithashtu kjo gjykatë konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të bazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë aktvendimi i organit administrativ i të paditurës nuk është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji i kësaj gjykate, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës, po ashtu nuk ka gjetur asnjë provë konkrete që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë. Meqë e paditura nuk ka dëshmuar me prova konkrete se paditësi ia ka paguar eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-in kontestues dhe faturën përcjellëse të mallit lëndor. Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, Kodi nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr.04/L-099.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të

paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe në nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.953/22, me datë 15.12.2022

**Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri**